



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më _____, 2024

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____, 2024

PËR

PËRCAKTIMIN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË DHE SHESHE NË
TERRITORIN E BASHKISË PRRENJAS

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 89/2022, datë 22.12.2005 "Për policinë bashkiake", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë". Udhëzimit Nr. datë 10.06.2008 "Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen subjektivit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë". Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.4, datë 27.12.2023 "Për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Prrenjas për vitin 2024" konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me anë të shkresës me Nr. 68/1 prot. dt.15.01.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Drejtorisë së të Ardhurave, Taksave dhe Tarifave Vendore; Drejtorisë të Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Aplikimit të Projekteve, pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga administrata e bashkisë, ku është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht domosdoshmëria e këtij shërbimi, shoqëruar me dokumentacionin përkatës në mbledhjen e datës _____, 2024.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E TE ARDHURAVE, TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më _____, 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr _____ Datë _____ 2024

“PËR CAKTIM AGJENTI TATIMOR PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64 “Për kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”, si edhe në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKB nr. 04. Datë 27.12.2023 “Për miratimin e paketës fiskale të bashkisë Prrenjas për vitin 2024” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 68/1 prot. datë 15.01.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Drejtorisë së të Ardhurave, Taksave dhe Tarifave Vendore, pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga administrata e bashkisë, në mbledhjen e datës _____, 2024,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë Agjent tatimor Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec sh.a për vjeljen e taksës së ndërtesës, tarifave (pastrim, ndriçim, gjelbërim) dhe taksave dhe tarifave të tjera të abonentëve familjarë për vitin 2024.
2. Masa e shpërblimit të agjentit tatimor për tarifatat do të jetë 1.5% e vlerës së arkëtuar.
3. Vjelja e detyrimit të pasqyrohet në faturën tatimore, detyrimi për çdo familje do të përpjestohet në muaj sipas marrëveshjes që do të lidhet me ujësjiellësin.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave, Taksave dhe Tarifave Vendore.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar si dhe pas shprehjes së ligjshëmërisë së Prefektit të Qarkut Elbasan.

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E FINANCES DHE BUXHETIT
SEKTORI I SHERBIMIT SOCIAL DHE STREHIMIT

Nr. ____ prot.

Prrenjas, më/...../2024

PROJEKT-VENDIM
Nr. ____ Datë ____

“PËR MIRATIM TË LISTËS SË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI BANESA ME KOSTO TË ULËT (BKU), NËPËRMJET PROJEKTIT TË SUBVENCIONIMIT TË INTERESAVE TË KREDISË NGA BUXHETI I SHETIT”

Në mbështetje të Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, VKM Nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr.453, datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, si dhe shkresës nr.19130 datë 19.10.2022 “Për shterimin e kuotave të vjetra të cilat janë të përcaktuara në shkresën nr.18627 datë 17.10.2019 “Mbi projektin e subvencionimit të interesave të kredisë” nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shkresës me nr.4592 prot, 07.02.2024 nga Raiffesin Bank Albania, VKB Prrenjas Nr.46, datë 27.03.2024 “Për miratimin e Sistemit të Pikëzimit për familjet/individët që kërkojnë të përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët (BKU)”, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe hartimit të listës përfituese sipas kriterëve përcaktuara në ligj nga Komisioni i Strehimit I ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, **Sektori i Shërbimit Social dhe Strehimit i Propozon Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij më datë ____/____/2024 të miratojë:**

1. Listën parësore prej 7 (shtatë) familje/individë, listën rezervë prej 4 (kater) familje/individë të cilët do të përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredisë. *(Bashkëngjitur Vendim i Komisionit të Strehimit 2024)*
2. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Sektori i Shërbimit Social dhe Strehimit dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) dite pas shpalljes-publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Konceptoi: SPECIALISTI I STREHIMIT E.KRYEZIU
Miratoi: PËRÇEGJËS I SHËRBIMIT SOCIAL B.HANA

KRYETARI I BASHKISË
Nuri BELBA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL DHE STREHIMIT

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më _____ 2024

PROJEKT-VENDIM
Nr. _____ Datë _____

**"PËR MIRATIMIN E LISTËS SHITESË TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË
SUBVENCIONIM QIRAJE PËR VITIN 2024 NË QYTETIN E PRRENJASIT"**

Bazuar në Ligjin nr.22/2018, "Për Strehimin Social", Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, VKM nr.362 datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM nr.384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM nr.459 datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", VKB Prrenjas Nr.45, datë 27.03.2024 "Për miratimin e Sistemit të Pikëzimit për familjet/individët që kërkojnë të përfitojnë nga programi i subvencionimit të qirasë", VKB Prrenjas nr.26, datë 07.02.2020 "Për përcaktimin e çmimit të qirasë të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg, për efekt të subvencionit të qirasë", Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.92 datë 05.02.2024 për "Ngritjen e Komisionit të Strehimit për vitin 2024", Sektori i Shërbimit Social dhe Strehimit i Propozon Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij më datë ____/____/2024 të miratojë:

1. Listën emërore shtesë të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje për vitin 2024. (Bashkangjitur tabela me listën emërore dhe shumat e subvencionimit).
2. Miratimin në parim të masës së subvencionit të qirasë me vlerë totale prej **388,000** lekë për periudhën (Korrik-Dhjetor) viti 2024, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën prej **310,400**lekë, dhe në masën 20% nga Bashkia Prrenjas në vlerën **77,600** lekë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Sektori i Shërbimit Social dhe Strehimit dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
4. Ky vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) dite pas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6 e ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Konceptoi: SPECIALIST I STREHIMIT E.KRYEZIU
Miratoi: PËRQJEGJËS I SHËRBIMIT SOCIAL. BHANA

KRYETARI I BASHKISË
Nuri BELBA

NË MUNGESË DHE ME URDIËR
ZV/KRYETAR I BASHKISË
Aurel KARRIQI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRRENJAS

Nr.....prot.

Përrenjas, më/...../2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ Datë _____

“Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga Fondi Social”

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57, datë 18.07.2019 ‘ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë’, bazuar gjithashtu në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i azhornuar me ligjin nr.10399 datë 17.03.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “ Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar në nenin 7, në VKM nr.787 datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, si dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, administratorja e zyrës së ndihmës ekonomike i propozon Këshillit të Bashkisë, të trajtohen me ndihmë ekonomike me kriter të veçantë:

1. Familje të varfëra të cilat janë refuzuar për shkaqe administrative nga sistemi i pikëzimit,
2. Familje shumë të varfëra që për shkaqe administrative dhe sociale nuk arrijnë të aplikojnë sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019“Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”
3. Familje të varfëra me një bashkëshort të larguar(apo në burg)dhe që nuk mund të fillojnë procedurat e divorcit, apo nuk sigurojnë dokumentat perkatës.
4. Familje me probleme të tjera sociale.

I propozoj Këshillit të Bashkisë të trajtohen nga Fondi Social i ndihmës ekonomike për muajin **KORRIK**, 3 familje me fond 24.000 LEKË.

Bashkëngjitur është lista e familjeve.
Përgjegjës i Shërbimit Social

Besim HANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më _____, 2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ Datë _____

"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike me 6% të fondit të kushtëzuar të bllok ndihmës ekonomike muaji KORRIK 2024".

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57, datë 18.07.2019 ' Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë', bazuar gjithashtu në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i azhurnuar me ligjin nr.10399 datë 17.03.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin në.9355 datë 10.03.2005 " Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar në nenin 7, në VKM nr.787 datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", si dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, administratorja e zyrës së ndihmës ekonomike i propozon Këshillit të Bashkisë, të trajtohen me ndihmë ekonomike me kriter të veçantë:

1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,
2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale,
3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune,
4. Familje me shumë fëmijë
5. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë që ndjekin universitetin;
6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/invalidë pune

I propozoj Këshillit të Bashkisë të trajtohen nga fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike për muajin **KORRIK**, 42 familje me fond **236.983 LEKË**.

Bashkëngjitur është lista e familjeve.

Përgjegjës i Shërbimit Social

Besim HANA

Kryetari i Bashkisë

Nuri BELBA